




NGA SHKOLLA TE PUNA: RAPORT MBI LIDHJEN MES ARSIMIT PROFESIONAL TË HOTELERI TURIZMIT DHE TREGUT TË PUNËS

AUTOR
IKESH

NGA SHKOLLA TE PUNA: RAPORT MBI LIDHJEN MES ARSIMIT PROFESIONAL TË HOTELERI TURIZMIT DHE TREGUT TË PUNËS

Raporti i monitorimit për kushtet e punës së motorristëve të Wolt në Shqipëri është përgatitur nga **Instituti për Kritikë dhe Emancipim Shoqëror (IKESH)**, me mbështetjen e **Rosa Luxemburg Stiftung (RLS)**. Opinionet, gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e shprehura në këtë publikim janë të autorëve dhe nuk reflektojnë domosdoshmërisht ato të donatorit. Ky publikim ose pjesë të tij mund të përdoren lirisht nga palë të tjera, me kushtin e vetëm që të citohet ky burim origjinal.

Adresa: Rruga 'Karl Gega', godina 1, Hyrja 1, Apartamenti 66, Tiranë, Shqipëri

Email: info@ikesh.org

Web: <https://ikesh.org/sq/>

Grupi i punës

Autorë të studimit:

Alfred Bushi, Ferdez Onuzi,
Ariela Zeneli

Redaktor:

Gabriel Rakaj

Publishing designer:

Kristi Çunga

Fotografia në kopertinë:

iMattSmart / Unsplash

Ky publikim ose pjesë të tij mund të përdoren lirisht nga palë të tjera, me kushtin e vetëm që të citohet ky burim origjinal.

Autor: Instituti për Kritikë dhe Emancipim Shoqëror (IKESH) © 2026

Falënderojmë përzemërsisht të gjithë ata që ndanë kohën dhe përpjekjet e tyre për ta bërë të mundur këtë studim.

HYRJE	5
Qëllimi i studimit	6
Pyetjet kërkimore	6
METODOLOGJIA	7
Kufizimet e monitorimit	7
KAPITULLI 1/ ZHVILLIMI I TURIZMIT, ARSIMIT DHE TRANSFORMIMET NË TREGUN E PUNËS	8
1.1 Zhvillimi i sektorit të turizmit dhe nevoja për fuqi punëtore të kualifikuar	8
1.2 Gjendja e arsimit profesional në Shqipëri	9
1.3 Arsimi profesional dhe lidhja me tregun e punës	11
1.4 Sfidat e arsimit profesional në Shqipëri dhe ndikimi në tranzicionin nga shkolla në punë	12
1.5 Po cilat janë perspektivat?	13
1.6 Kuadri strategjik: si konceptohet lidhja mes arsimit profesional dhe zhvillimit të turizmit	13
2.4. Standardet ndërkombëtare: ILO dhe Bashkimi Evropian	15
KAPITULLI 2/ RAPORT MBI LIDHJEN MES INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT PROFESIONAL, INSTITUCIONEVE SHTETËRORE DHE BIZNESIT, NGA PERSPEKTIVA E DREJTUESVE TË INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT PROFESIONAL	16
2.1 Aspekti institucional	16
2.2 Popullata e nxënësve	17
2.3 Marrëdhënia e biznesit dhe tregut të punës	18
KAPITULLI 3/ PERSPEKTIVA E NXËNËSVE MBI LIDHJEN MES INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT PROFESIONAL, INSTITUCIONEVE SHTETËRORE DHE BIZNESIT	19
3.1 Vlerësimi i shkollës, formimit teorik dhe praktik (laboratorët)	19
3.2 Praktika profesionale në biznese	20
3.3 Sfidat, shfrytëzimi dhe kushtet e punës	20
3.4 E ardhmja profesionale	22
KAPITULLI 4/ ROLI I AKPA-SË NË MENAXHIMIN E ARSIMIT PROFESIONAL DHE INTEGRIMIN E TË RINJVE NË TREGUN E PUNËS	23
ARTIKULLI 5/ NGA SHKOLLA TE BIZNESI, PARË NË KËNDVËSHTRIMIN E BIZNESIT	25
PËRFUNDIME	26
REKOMANDIME	27
BIBLIOGRAFIA	28

HYRJE

Shqipëria është një vend ku sektori i shërbimeve zë një peshë dominuese në ekonomi dhe ku, gjatë dekadës së fundit, turizmi është shndërruar në një nga motorët kryesorë të zhvillimit ekonomik. Rritja e vazhdueshme e numrit të turistëve, zgjerimi i kapaciteteve akomoduese dhe investimet në infrastrukturën turistike kanë krijuar një kërkesë gjithnjë e më të madhe për fuqi punëtore. Megjithatë, ndërsa vëmendja publike dhe institucionale është përqendruar kryesisht te shifrat e vizitorëve, të ardhurat dhe investimet, më pak vëmendje i është kushtuar një pyetjeje po aq të rëndësishme: a po arrin sistemi arsimor të përgatisë burimet njerëzore që kërkon ky zhvillim? Me fjalë të tjera, a po ecën zhvillimi i turizmit paralelisht me zhvillimin e kapaciteteve profesionale të të rinjve që synojnë të punojnë në këtë sektor?

Kjo pyetje bëhet edhe më e rëndësishme në kushtet kur dokumentet strategjike kombëtare e identifikojnë mungesën e fuqisë punëtore të kualifikuar si një nga sfidat kryesore të sektorit. Strategjia Kombëtare e Turizmit 2024–2030 argumenton se rritja e sektorit nuk mund të mbështetet vetëm në investime fizike apo në zgjerimin e kapaciteteve akomoduese, por kërkon edhe investime të qëndrueshme në kapitalin njerëzor. Në këtë kuadër, arsimi profesional paraqitet si një mekanizëm kyç për përgatitjen e punonjësve të ardhshëm të industrisë së turizmit dhe hotelierisë. Për këtë arsye, vitet e fundit është vendosur theksi te harmonizimi i kurrikulave me nevojat e tregut, forcimi i praktikave profesionale dhe zgjerimi i bashkëpunimit mes shkollave dhe bizneseve.

Megjithatë, ekziston një hendek i mundshëm mes objektivave të parashikuara në strategji dhe mënyrës se si këto politika materializohen në praktikë. Nga njëra anë, bizneset raportojnë vështirësi në gjetjen e stafit të kualifikuar; nga ana tjetër, shkollat profesionale përballen me sfida që lidhen me tërheqjen e nxënësve, përditësimin e kurrikulave dhe sigurimin e praktikave cilësore. Në të njëjtën kohë, të rinjtë që ndjekin këto profile përballen me pyetje konkrete mbi mundësitë reale të punësimit, kushtet e punës dhe perspektivat afatgjata të karrierës në sektor. Kjo tregon se marrëdhënia mes arsimit profesional dhe tregut të punës nuk mund të kuptohet vetëm përmes dokumenteve strategjike, por duhet analizuar edhe përmes përvojave konkrete të aktorëve që e përfetojnë atë çdo ditë.

Pikërisht në këtë kontekst vendoset ky raport. Ai synon të analizojë marrëdhënien ndërmjet arsimit profesional në fushën e hotelieri-turizmit dhe tregut të punës në Shqipëri, duke shqyrtuar jo vetëm atë që parashikojnë strategjitë dhe politikat publike, por edhe mënyrën se si kjo marrëdhënie funksionon në praktikë. Përmes intervistave me drejtues të shkollave profesionale, përfaqësues të biznesit, nxënës dhe institucione publike, raporti përpiqet të kuptojë nëse sistemi aktual po arrin të krijojë ura efektive midis shkollës dhe punës, cilat janë sfidat që vazhdojnë të ekzistojnë dhe çfarë mund të përmirësohet për ta bërë këtë tranzicion më të suksesshëm për të rinjtë dhe më të dobishëm për zhvillimin e sektorit të turizmit.

Qëllimi i studimit

Qëllimi i këtij raporti është të analizojë marrëdhënien ndërmjet arsimit profesional në fushën e hotelieri-turizmit dhe tregut të punës në Shqipëri, duke shqyrtuar shkallën e përputhshmërisë mes aftësive që ofron sistemi arsimor dhe nevojave të sektorit të turizmit, të analizojë sfidat me të cilat përballlet ky sistem sot dhe të kontribuojë në formulimin e rekomandimeve për forcimin e tranzicionit nga shkolla në punë.

Pyetjet kërkimore

Ky raport përfshin **pyetjen kryesore kërkimore** që është:

Në çfarë mase sistemi i arsimit profesional në fushën e hotelieri-turizmit po arrin të përgatisë të rinjtë për integrimin në tregun e punës?

Ndërkohë pyetje të tjera kërkimore janë:

1. **Si është ndërtuar dhe si funksionon bashkëpunimi ndërmjet shkollave profesionale, biznesit dhe institucioneve publike në sektorin e turizmit?**
2. **Sa përputhen aftësitë dhe njohuritë që fitojnë nxënësit në shkollë me kërkesat e tregut të punës?**
3. **Cilat janë përvojat dhe sfidat kryesore të të rinjve gjatë kalimit nga arsimi profesional në punësim?**
4. **Si e vlerësojnë bizneset, shkollat dhe Agjencia Kombëtare e Punës dhe Aftësive efektivitetin e mekanizmave ekzistues që synojnë lidhjen mes arsimit profesional dhe tregut të punës?**
5. **Cilat janë sfidat dhe mundësitë kryesore për forcimin e lidhjes mes arsimit profesional dhe tregut të punës në sektorin e turizmit?**

METODOLOGJIA

Ky raport mbështetet në një qasje cilësore kërkimore, përmes perspektivave të aktorëve të ndryshëm të përfshirë në këtë proces. Për realizimin e raportit janë përdorur dy metoda kryesore: analiza e dokumenteve dhe intervistat gjysmë të strukturuar. Analiza fillestare është fokusuar në shqyrtimin e strategjive kombëtare, politikave publike që lidhen me arsimin profesional, të dhënat që lidhen me punësimin e të rinjve dhe zhvillimin e sektorit të turizmit në Shqipëri. Kjo analizë ka shërbyer për të kuptuar objektivat dhe mekanizmat institucionalë që synojnë forcimin e lidhjes ndërmjet shkollës dhe tregut të punës.

Për t'u dhënë përgjigje pyetjeve kërkimore janë zhvilluar intervista gjysmë të strukturuar me katër kategori aktorësh:

- **4** drejtues dhe përfaqësues të shkollave profesionale në fushën e hoteleri-turizmit;
- **17** nxënës të shkollave profesionale ose të rinj të sapodiplomuar në profilet e hoteleri-turizmit;
- **1** përfaqësues të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive (AKPA).

Intervistat janë realizuar mbi bazën e udhërrëfyesve të veçantë për secilën kategori, duke trajtuar tema të tilla si përputhshmëria e kurrikulës me nevojat e tregut, bashkëpunimi mes shkollave dhe bizneseve, përvojat e praktikave profesionale, procesi i punësimit të të rinjve, si dhe roli i institucioneve publike në ndërmjetësimin e këtij tranzicioni.

Të gjitha intervistat janë zhvilluar në mënyrë konfidenciale dhe citimet e përdorura në raport janë anonimizuar për të garantuar mbrojtjen e identitetit të pjesëmarrësve.

Kufizimet e studimit

Gjatë kësaj periudhe raporti ka pasur edhe kufizimet e veta. Së pari, procesi i mbledhjes së të dhënave u ndikua nga vonesa të lidhura me procedurat administrative dhe koordinimin institucional, të cilat zgjatën afatet e planifikuara për realizimin e intervistave. Kjo ndikoi në ritmin e zhvillimit të kërkimit dhe në disponueshmërinë e disa aktorëve për t'u përfshirë në kohën e parashikuar.

Së dyti, raporti hasi vështirësi në sigurimin e intervistave me përfaqësues të biznesit të sektorit hotelier. Periudha e mbledhjes së të dhënave përkoi me sezonin turistik dhe me një ngarkesë të lartë pune për shumë prej operatorëve të sektorit, çka kufizoi mundësinë e tyre për të marrë pjesë në intervista. Pavarësisht përpjekjeve të bëra për të kontaktuar një numër të konsiderueshëm biznesesh, nuk arrit të kryhej asnjë intervistë. Për të mbushur sadopak këtë boshllëk, jemi munduar të paraqesim pikëpamjet e studiuesve të fushës që merren me analizën e tregut të punës dhe nevojat e tij.

Megjithatë, intervistat e realizuara me shkollat profesionale, institucionet publike dhe vetë nxënësit mundësuan mbledhjen e informacionit të mjaftueshëm për të identifikuar tendencat, sfidat dhe perceptimet kryesore që karakterizojnë marrëdhënien ndërmjet arsimit profesional dhe tregut të punës në sektorin e turizmit.

KAPITULLI 1/ ZHVILLIMI I TURIZMIT, ARSIMIT DHE TRANSFORMIMET NË TREGUN E PUNËS

1.1 Zhvillimi i sektorit të turizmit dhe nevoja për fuqi punëtore të kualifikuar

Gjatë viteve të fundit, turizmi është shndërruar në një nga sektorët më të rëndësishëm të ekonomisë shqiptare. Më parë ekonomia mbështetej kryesisht në sektorë si bujqësia, tregtia apo remitancat. Ndërkohë sipas të dhënave të INSTAT, sektorët kryesorë në ekonomi janë ndërtimi dhe turizmi. Kjo lidhet me rritjen e numrit të turistëve dhe strukturave akomoduese dhe orientimin e investimeve drejt zonave bregdetare.

Gjatë viteve 2020–2024, të ardhurat direkte nga turizmi kaluan nga nivele shumë të ulëta në rritje të ndjeshme duke reflektuar rimëkëmbjen dhe forcimin e sektorit. Në vitin 2020, për shkak të pandemisë, turizmi solli vetëm **856 milionë euro**, duke përbërë **5.6%** të PBB-së. Bumi i vërtetë i turizmit u shënua pas pandemisë, me hyrjet e turistëve të huaj që kaluan për herë të parë shifrën “10 milionë në 2023 dhe 11.7 milionë në 2024” (Strategjia Kombëtare për Zhvillimin e Turizmit 2025–2030, f. 10; Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, 2025). Për vitin 2025 turizmi kontribuoi me 25% në PBB, rreth 6,5 miliard euro (Altax, 2025). Për sa i përket produktivitetit, turizmi është mbi mesataren kombëtare (rreth 13,500 € për punonjës), por ende prapa vendeve fqinje (Altax, 2025). Megjithatë, kur merren në konsideratë edhe efektet indirekte dhe të induktuara në sektorë të tjerë të ekonomisë, ndikimi i tij vlerësohet të jetë disa herë më i lartë. Turizmi nuk gjeneron të ardhura vetëm për bizneset e hotelarisë dhe gastronomisë, por ushqen një zinxhir të gjerë aktiviteteve ekonomike që lidhen me transportin, tregtinë, ndërtimin, shërbimet dhe prodhimin lokal. Për këtë arsye, zhvillimi i tij ka filluar të ndikojë jo vetëm në treguesit makroekonomikë, por edhe në strukturën e tregut të punës dhe orientimin e investimeve publike dhe private.

Rritja e sektorit është reflektuar qartë edhe në numrin e vizitorëve. Sipas të dhënave të INSTAT, Shqipëria regjistroi në vitin 2024 një rritje prej 82% të numrit të turistëve krahasuar me vitin 2019. “Në vitin 2021 Shqipërinë e kanë vizituar 6.4 milionë turistë, në vitin 2022 kanë ardhur 7.5 milionë turistë. Me një rritje në vitin 2023 me rreth 10.15 milionë turistë dhe për vitin 2024 që kemi pasur 11.69 milionë turistë.” (Analiza shumëdimensionale e turizmit në Shqipëri 2024). Për vitin 2025 llogaritet të kenë hyrë rreth 12.46 milion vizitorë sipas (Altax, 2025).

Megjithatë, zhvillimi i turizmit nuk mund të kuptohet vetëm përmes shifrave të investimeve apo të numrit të turistëve. Një nga aspektet më të rëndësishme lidhet me ndikimin e tij në tregun e punës, sepse bazohet tek puna njerëzore dhe aftësitë njerëzore. Në këtë kuptim, rritja e sektorit ka krijuar kërkesë gjithnjë e më të rritur për fuqi punëtore në profile të ndryshme, duke filluar nga kamarierët, recepsionistët dhe kuzhinierët, deri te menaxherët e hoteleve, specialistët e marketingut turistik dhe ekspertët e menaxhimit të destinacioneve. Për vitin 2024, vlerësohet

se në të gjithë sektorin e turizmit janë të punësuar rreth 40,000 persona. Nga këta, afërsisht 20,000 janë të angazhuar në turizmin bregdetar, segmenti më dinamik i industrisë turistike në vend (Monitor, 2025).

Në **Strategjinë Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive 2023–2030** përmenden edhe sfidat me të cilat përballen bizneset në Shqipëri. (Ministria e Financave, 2022). Në këtë strategji identifikohen disa nga shqetësimet e raportuara nga bizneset që lidhen me **mungesëm e punonjësve të kualifikuar dhe raporti i pabalancuar midis pagesës dhe produktivitetit në punë**. Aty përmendet se raporti i fundit i Dhomës Amerikane të Tregtisë mbi Indeksin e Biznesit në Shqipëri për vitin 2024 thotë se pesë shqetësimet kryesore të raportuara nga të anketuarit për vitin 2024 mbetën: gjetja e stafit lokal të kualifikuar (73.3% i bizneseve që janë përgjigjur), monopoli dhe konkurrenca e pandershme, ekonomia informale, burokracia qeveritare dhe niveli i përgjithshëm i taksave të aplikuara.

Projeksionet e Strategjisë Kombëtare për Zhvillimin e Turizmit 2025–2030 (Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, 2025) tregojnë se kërkesa për fuqi punëtore do të vazhdojë të rritet ndjeshëm. Strategjia parashikon që numri i të punësuarve në sektor të arrijë në rreth 73,000 persona, krahas zgjerimit të kapaciteteve akomoduese dhe investimeve të planifikuara për vitet në vijim. Kjo perspektivë ngre dy pyetje thelbësore: së pari, nëse oferta aktuale e fuqisë punëtore është e mjaftueshme për të përballuar nevojat që krijon sezoni turistik, dhe së dyti, nga cilat burime do të sigurohet fuqia punëtore shtesë që kërkon zgjerimi i mëtejshëm i sektorit. Pikërisht këto sfida e vendosin në qendër të debatit marrëdhënien ndërmjet sistemit arsimor, formimit profesional dhe tregut të punës në turizëm.

1.2 Gjendja e arsimit profesional në Shqipëri

Arsimi dhe Formimi Profesional (AFP) mbështetet në ndërthurjen e njohurive teorike me aftësitë praktike dhe mund të zhvillohet në arsimin e mesëm, të lartë dhe në programet pasuniversitare. Sipas UNESCO-s, termi **VET** (Vocational Education and Training) përfshin atë pjesë të procesit arsimor që, përveç formimit të përgjithshëm, synon zhvillimin e aftësive praktike dhe njohurive profesionale të nevojshme për ushtrimin e një profesioni. Në të njëjtën linjë, Stephen Billet e përkufizon arsimin profesional si një formë edukimi që synon pajisjen e individëve me njohuritë dhe kompetencat e nevojshme për të rritur efikasitetin dhe performancën në një profesion të caktuar (Billet, 2011).

Edhe legjislacioni shqiptar për Arsimin dhe Formimin Profesional thekson se misioni i këtij sistemi është zhvillimi i aftësive personale dhe profesionale të individit, duke e përgatitur atë për tregun e punës dhe për një jetë të pavarur. Studime të ndryshme kanë dëshmuar se arsimi profesional sjell përfitime të rëndësishme ekonomike dhe sociale. Ndër efektet më të spikatura janë reduktimi i papunësisë, rritja e mundësive për të fituar kualifikime profesionale, përmirësimi i perspektivave për zhvillim në karrierë dhe rritja e produktivitetit të individëve në vendin e punës. Raporti i OECD (OECD, 2025) **Education at a Glance 2025** evidenton se arsimi profesional përbën një nga mekanizmat më efektivë për përgatitjen e të rinjve për tregun e punës dhe veçanërisht në vendet ku arsimi profesional është i lidhur ngushtë me nevojat e industrisë, ai krijon mundësi tërheqëse karriere dhe rrit ndjeshëm punësueshmërinë e të diplomuarve. Një

element kyç i këtyre programeve është mësimi në vendin e punës, përmes praktikave profesionale ose modeleve të praktikantëve (*apprenticeships*), të cilat ndihmojnë në zhvillimin jo vetëm të aftësive teknike, por edhe të kompetencave ndërpersonale, si komunikimi, bashkëpunimi dhe menaxhimi i konflikteve. Këto aftësi zhvillohen më efektivisht në mjedise reale pune sesa në klasë. Raporti thekson gjithashtu se personat që përfundojnë programe profesionale të nivelit terciar afatshkurtër arrijnë një normë mesatare punësimi prej **83%**, ndërsa kualifikimet profesionale shërbejnë si tregues të ekspertizës së specializuar, duke rritur mundësinë për punësim më të qëndrueshëm dhe më të mirëpaguar. Një tjetër gjetje e rëndësishme është se papunësia afatgjatë është më e ulët tek individët me arsim profesional të mesëm ose post-sekondar (**30%**) krahasuar me ata që nuk kanë përfunduar arsimin e mesëm (**36%**), çka tregon rolin mbrojtës të këtij lloji arsimi ndaj përjashtimit afatgjatë nga tregu i punës (OECD, 2025).

Në Shqipëri, arsimi profesional ka fituar rëndësi të veçantë vitet e fundit si rezultat i nevojës për të reduktuar mospërputhjen ndërmjet sistemit arsimor dhe kërkesave të tregut të punës. Politikat publike e konsiderojnë AFP-në si një instrument kyç për rritjen e punësimit të të rinjve, zhvillimin e kapitalit njerëzor dhe përmirësimin e konkurrueshmërisë së ekonomisë. Strategjia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive 2023–2030 e identifikon zhvillimin e aftësive si një nga shtyllat kryesore të zhvillimit ekonomik të vendit, duke vendosur në qendër të saj përmirësimin e lidhjes ndërmjet ofertës arsimore dhe kërkesës së tregut të punës. Sektorët prioritarë të zhvillimit, si turizmi, teknologjia e informacionit, energjia dhe bujqësia, kërkojnë fuqi punëtore të kualifikuar, çka e bën arsimin profesional një element thelbësor të politikave të zhvillimit.

Sistemi publik i arsimit profesional në Shqipëri administrohet nga Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive (AKPA) dhe përfshin rreth 35 shkolla profesionale të shpërndara në të gjithë territorin e vendit. Këto institucione ofrojnë programe në fusha të ndryshme, si teknologjia e informacionit, elektroteknika, mekanika, ndërtimi, bujqësia, hotelieri-turizmi dhe shërbimet. Gjatë viteve të fundit janë ndërmarrë reforma që synojnë modernizimin e kurrikulave, zgjerimin e sistemit dual¹, rritjen e praktikës profesionale pranë bizneseve dhe harmonizimin e Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve me Kornizën Evropiane të Kualifikimeve. Këto reforma kanë synuar ta afrojnë sistemin shqiptar me standardet e Bashkimit Evropian dhe ta bëjnë arsimin profesional më të orientuar drejt kompetencave konkrete që kërkon tregu i punës.

Megjithëse vëmendja institucionale ndaj arsimit profesional është rritur, pjesëmarrja e të rinjve në këtë sistem mbetet relativisht e kufizuar krahasimisht me arsimin e mesëm të përgjithshëm. Sipas të dhënave të INSTAT-it, në vitin shkollor 2024–2025, në arsimin profesional ishin regjistruar 16,987 nxënës, krahasuar me 72,203 nxënës në arsimin e mesëm të përgjithshëm. Krahasuar me vitin shkollor 2020–2021, kur numri i nxënësve në arsimin profesional ishte 19,024, evidentohet një rënie e regjistrimeve, ndonëse kjo lidhet pjesërisht edhe me rënien e përgjithshme të popullsisë shkollore. Në të njëjtën periudhë, numri total i nxënësve në arsimin e mesëm ka rënë nga 107,989 në 89,190, çka pasqyron edhe probleme të tjera që po përballet vendi ynë (emigracioni, rënia e lindshmërisë dhe ndryshimet demografike etj.). Kjo gjë ndodh edhe për shkak të perceptimit të të rinjve ndaj arsimit profesional, sepse shumë herë është konsideruar si alternativë e dytë ndaj arsimit të përgjithshëm ose universitar. Për këtë arsye, një nga objektivat kryesorë të politikave arsimore është rritja e interesit të nxënësve për këto degë. Kjo është edhe arsyeja që sot është zgjeruar modeli dual i mësimdhënies.

1 Sistemi dual shtë një model arsimor i aplikuar nga AKPA që ndërthur mësimin teorik në shkollë me praktikën në një biznes. Një pjesë të orëve nxënësit i kalojnë në bankat e shkollës duke marrë njohuri teorike dhe pjesën tjetër në vendin e punës, duke fituar eksperiencë konkrete dhe aftësi të kërkuara nga tregu i punës.

Megjithatë sektori i turizmit rritet shumë shpejt dhe arsimi profesional i hotelieri-turizmit përballlet me sfida që lidhën me sasinë (numrin e nxënësve), me cilësinë e formimit, përputhjen e kurrikulave me nevojat e ekonomisë dhe tranzicionin efektiv nga shkolla në punë. Sipas të dhënave të vëna në dispozicion nga AKPA, në degën hotelieri-turizëm janë të regjistruar rreth 3144 nxënës, të shpërndarë në qytetet kryesore të vendit.

1.3 Arsimi profesional dhe lidhja me tregun e punës

Një nga funksionet kryesore të arsimit profesional është lehtësimi i kalimit të të rinjve nga sistemi arsimor drejt tregut të punës. Në literaturën ndërkombëtare ky proces njihet si **school-to-work transition**, ku përfshin periudhën gjatë të cilës individi kalon nga arsimi në punësim dhe konsiderohet si një nga periudhat më të rëndësishme sepse ndikon edhe tek stabiliteti i karrierës. Për të matur vështirësitë e këtij tranzicioni, OECD përdor treguesin **NEET** (*Not in Employment, Education or Training*), i cili përfshin të rinjtë që nuk janë as në punësim, as në arsim dhe as në trajnim. Një nivel i lartë i këtij treguesi sinjalizon vështirësi në integrimin e të rinjve në tregun e punës dhe tregon se sistemi arsimor nuk po arrin të krijojë ura të mjaftueshme lidhëse me ekonominë. Sipas Strategjisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive 2023–2030, në Shqipëri **26.1%** e të rinjve të moshës 15–29 vjeç klasifikoheshin si NEET në vitin 2021, megjithëse ky tregues ka shënuar përmirësim krahasuar me vitin 2014, kur arrinte në **34.5%**. Këto shifra tregojnë se një pjesë e konsiderueshme e të rinjve vazhdon të mbetet jashtë sistemit arsimor dhe tregut të punës, duke humbur mundësi të rëndësishme për zhvillim profesional.

Njëkohësisht, papunësia e të rinjve mbetet një nga sfidat kryesore të tregut shqiptar të punës. Sipas të njëjtës strategji, shkalla e papunësisë tek të rinjtë ishte **27.1%** në vitin 2021, më shumë se dyfishi i shkallës së përgjithshme të papunësisë. Ky fakt tregon se kalimi nga shkolla drejt punës vazhdon të jetë një proces i vështirë, veçanërisht për ata që nuk zotërojnë aftësitë praktike të kërkuara nga punëdhënësit. Dokumenti nënvizon se, përveç mungesës së përvojës profesionale, në këtë situatë ndikojnë edhe mospërputhja ndërmjet formimit dhe kërkesës së tregut, kushtet e punës, niveli i pagave dhe mundësitë e kufizuara për zhvillim profesional.

Strategjia Kombëtare e Punësimit ka evidentuar gjithashtu që se shumë biznese hasin vështirësi në lidhje me gjetjen e punonjësve të kualifikuar. Specifikisht **51%** e tyre deklarorin se kishin mungesë të fuqisë punëtore të kualifikuar dhe raportojnë se kandidatëve u mungojnë jo vetëm kompetencat profesionale, por edhe të ashtuquajturat **aftësi të buta**, si komunikimi, puna në grup, zgjidhja e problemeve dhe përgjegjshmëria në punë. Rezultatet e programit **Skills for Jobs (S4J)** (<https://skillsforjobs.al>, a.d.) mbështesin këtë qasje. Studimet gjurmuese të realizuara në shkollat profesionale të mbështetura nga ky program tregojnë se rreth **70–71%** e të diplomuarve punësohen brenda vitit të parë pas përfundimit të shkollës. Një rezultat edhe më domethënës është fakti se mbi **70%** e nxënësve sigurojnë kontratë pune ose premtim punësimi që gjatë periudhës së praktikës profesionale, ndërsa më shumë se **55%** e tyre punojnë pikërisht në profesionin për të cilin janë trajnuar. Këto të dhëna tregojnë se lidhja e drejtpërdrejtë ndërmjet shkollës dhe biznesit rrit ndjeshëm mundësinë e integritit në tregun e punës.

1.4 Sfidat e arsimit profesional në Shqipëri dhe ndikimi në tranzicionin nga shkolla në punë

Të gjitha këto raporte ose strategji theksojnë njëzëri cilësinë e lidhjes ndërmjet sistemit arsimor dhe nevojave reale të ekonomisë. Ajo që ndodh praktikisht është **mospërputhja ndërmjet aftësive të fituara gjatë arsimit dhe kërkesave të tregut të punës** (*skills mismatch*). Edhe pse kërkesa është shumë e lartë, sërish ka sfida për sa i përket formimit profesional. Një tjetër faktor që duhet përmendur lidhet edhe me cilësinë e praktikës profesionale, sepse në një vend ku emigrimi është i lartë, në rajone ose qytete më të vogla ka mungesë të mentorëve të trajnuar, pajisjeve bashkëkohore dhe strukturës administrative të qartë të shpërndarjes së kompetencave. Një tjetër problem lidhet edhe me mungesën **e mësuesve me përvojë të drejtpërdrejtë në industri**. Shpeshherë ndodh që ky sektor kërkon përditësim të vazhdueshëm të njohurive profesionale dhe sistemi arsimor ende has vështirësi në tërheqjen dhe mbajtjen e specialistëve të industrisë në procesin e mësimdhënies. Po aq e rëndësishme është edhe zhvillimi i **aftësive të buta** (*soft skills*). Punëdhënësit nuk kërkojnë vetëm njohuri teknike, por edhe aftësi si komunikimi efektiv, bashkëpunim në punën në grup, përshtatshmëri dhe orientim ndaj klientit. Këto kompetenca kanë një rëndësi të veçantë në sektorin e hoteleri-turizmit, ku cilësia e shërbimit varet në masë të madhe nga ndërveprimi i drejtpërdrejtë me klientin. OECD thekson se këto aftësi zhvillohen më mirë nëpërmjet praktikës në vendin e punës sesa vetëm përmes mësimi teorik, çka e bën edhe më të rëndësishëm bashkëpunimin me biznesin.

Një sfidë shtesë është **emigracioni i fuqisë punëtore të re**. Strategjia Kombëtare e Punësimit vëren se vitet e fundit ka ndryshuar profili i emigracionit shqiptar. Nëse më parë emigronin të rinj me kualifikim të ulët, sot largohen gjithnjë e më shumë të rinj me arsim profesional ose universitar, të cilët kërkojnë nga tregjet e punës të vendeve të Bashkimit Evropian. Kjo krijon mungesa të ndjeshme në sektorë strategjikë të ekonomisë shqiptare, veçanërisht në hoteleri, turizëm, ndërtim dhe teknologjinë e informacionit. Për pasojë, sistemi arsimor përgatit specialistë që shpesh kontribuojnë në ekonominë e vendeve të tjera dhe jo në zhvillimin ekonomik të Shqipërisë.

Deri në këtë moment kemi folur vetëm për problemet që lidhen me sistemin arsimor, por nuk duhen harruar kushtet e punës dhe cilësia e punësimit. Strategjia Kombëtare e Punësimit thekson se punësimi informal mbetet ende i përhapur në sektorin e turizmit, veçanërisht për punëtorët sezonalë. Gjithashtu një tjetër aspekt lidhet me punësimin e të miturve dhe të nxënësve të arsimit profesional gjatë periudhës së praktikës ose gjatë sezonit turistik. Legjislacioni shqiptar lejon punësimin e personave që kanë mbushur moshën 16 vjeç, me kusht që puna të mos rrezikojë shëndetin, zhvillimin fizik apo vijimin e arsimit të tyre. Në këtë kuptim, praktikat duhen mbikëqyrur me kujdes nga institucionet për respektimin e të drejtave në punë. Kjo kërkon edhe një vëmendje të shtuar të Inspektoriatit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, institucioneve arsimore dhe punëdhënësve.

Gjithashtu, një pjesë e bizneseve deklarojnë paga më të ulëta nga ato reale ose përdorin forma fleksible punësimi që kufizojnë sigurinë ekonomike të punonjësve. Për këtë arsye, suksesi i arsimit profesional nuk duhet të matet vetëm me normën e punësimit, por edhe me cilësinë e vendeve të punës që arrijnë të sigurojnë të diplomuarit.

1.5 Po cilat janë perspektivat?

Zhvillimi i arsimit profesional në Shqipëri është shndërruar në një nga prioritetet kryesore të politikave publike, si rezultat i nevojës për të përmirësuar punësimin e të rinjve dhe për të siguruar fuqi punëtore të kualifikuar për sektorët strategjikë të ekonomisë. Në këtë kuptim, dokumentet strategjike të viteve të fundit tregojnë një orientim të qartë drejt forcimit të lidhjes ndërmjet sistemit arsimor dhe tregut të punës, duke synuar që arsimi profesional të mos funksionojë vetëm si një hallkë e sistemit arsimor, por edhe si një instrument i zhvillimit ekonomik dhe social.

Një nga dokumentet më të rëndësishme është **Strategjia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive 2023–2030**, e cila synon rritjen e punësimit, përmirësimin e cilësisë së arsimit profesional dhe zhvillimin e aftësive që kërkon ekonomia moderne. Strategjia thekson se përballë ndryshimeve demografike, emigracionit dhe zhvillimit teknologjik, Shqipëria duhet të investojë më shumë në kapitalin njerëzor, duke modernizuar programet profesionale dhe duke forcuar bashkëpunimin me sektorin privat. Një nga objektivat kryesore është që institucionet e arsimit profesional të përshtasin vazhdimisht ofertën e tyre me kërkesën e tregut të punës, përmes analizave periodike të nevojave për profesione dhe aftësi. Në të njëjtën linjë, **Strategjia Kombëtare e Turizmit 2025–2030** e konsideron zhvillimin e kapitalit njerëzor si një nga shtyllat kryesore të rritjes së sektorit. Strategjia pranon se zgjerimi i industrisë turistike nuk mund të mbështetet vetëm në investime në infrastrukturë apo në rritjen e numrit të turistëve, por kërkon edhe punonjës të kualifikuar. Për këtë arsye, dokumenti parashikon rritjen e numrit të nxënësve në programet profesionale të hotelieri-turizmit nga rreth **2,900** në **4,662**, si dhe zgjerimin e programeve universitare nga **2,312** në **3,810** studentë. Krahas rritjes së numrit të të diplomuarve, strategjia propozon përditësimin e kurrikulave, zgjerimin e praktikës profesionale, krijimin e qendrave rajonale të kompetencës dhe forcimin e bashkëpunimit ndërmjet shkollave, universiteteve dhe industrisë turistike. Këto masa synojnë të sigurojnë që zhvillimi i turizmit të mbështetet mbi një fuqi punëtore të aftë dhe konkurruese.

Një rol të rëndësishëm në këto politika zë edhe **Garancia Rinore (Youth Guarantee)**², e cila është përshtatur në Shqipëri në përputhje me modelin e Bashkimit Evropian. Kjo nismë synon që çdo i ri, brenda një periudhe të shkurtër pas përfundimit të arsimit ose humbjes së vendit të punës, të marrë një ofertë konkrete për punësim, praktikë profesionale, trajnim ose vazhdim studimesh. Në këtë mënyrë, Garancia Rinore synon të reduktojë numrin e të rinjve që mbeten jashtë arsimit dhe tregut të punës (NEET), duke lehtësuar tranzicionin nga shkolla drejt punësimit. Zbatimi efektiv i kësaj politike kërkon bashkëpunim të ngushtë ndërmjet institucioneve arsimore, Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, punëdhënësve dhe pushtetit vendor. Një tjetër element kyç i reformimit të arsimit profesional është **zgjerimi i sistemit dual**. Ky model kombinon mësimin teorik në shkollë me praktikën në ndërmarrje, duke i lejuar nxënësit të fitojnë përvojë reale pune gjatë procesit të formimit. Përvoja e vendeve të Bashkimit Evropian dhe rekomandimet e OECD-së tregojnë se sistemi dual redukton kohën e kalimit nga arsimi në punësim, rrit punësueshmërinë e të rinjve dhe u mundëson bizneseve të përgatisin punonjës sipas nevojave të tyre specifike. Në Shqipëri, ky model është zgjeruar gradualisht, megjithatë

² Garancia Rinore është një iniciativë e financuar nga Bashkimi Evropian, e cil synon të garantojë që çdo person i ri i papunë të ketë mundësinë për të siguruar punësim, për të marrë një profesion, apo për të vazhduar arsimin brenda katër muajve.

zbatimi i tij mbetet i pabarabartë ndërmjet rajoneve dhe sektorëve ekonomikë. Forcimi i bashkëpunimit me biznesin dhe krijimi i mekanizmave të qëndrueshëm të financimit mbeten ndër kushtet kryesore për suksesin e këtij modeli.

1.6 Kuadri strategjik: si konceptohet lidhja mes arsimit profesional dhe zhvillimit të turizmit

Zhvillimi i shpejtë i sektorit të turizmit ka sjellë në qendër të vëmendjes çështjen e përgatitjes së fuqisë punëtore. Nëse dekada e fundit është karakterizuar nga rritja e numrit të turistëve, investimeve dhe kapaciteteve akomoduese, dokumentet strategjike të viteve të fundit tregojnë se sfida kryesore e periudhës së ardhshme lidhet me aftësinë për të siguruar burime njerëzore të kualifikuara. Në këtë kuadër, arsimi profesional dhe formimi i vazhdueshëm shihen gjithnjë e më shumë si instrumente të domosdoshme për të mbështetur zhvillimin e sektorit.

Një nga dokumentet që e trajton më qartë këtë çështje është Strategjia Kombëtare e Turizmit 2024–2030. Dokumenti identifikon mungesën e forcës punëtore të kualifikuar si një nga pengesat kryesore për zhvillimin e mëtejshëm të sektorit (f. 15). Sipas strategjisë, emigrimi i punonjësve dhe mospërputhja ndërmjet programeve të arsimit dhe nevojave reale të industrisë rrezikojnë cilësinë e shërbimeve dhe kufizojnë potencialin e rritjes. Për këtë arsye, strategjia argumenton se është i domosdoshëm përafrimi i programeve të arsimit dhe formimit profesional me kërkesat konkrete të tregut të punës.

Në analizën e saj, strategjia nuk e trajton arsimin si një sektor të ndarë nga ekonomia, por si pjesë integrale të politikës së zhvillimit të turizmit. Në skenarin e zhvillimit të qëndrueshëm, një nga ndërhyrjet kryesore në aspektin social lidhet pikërisht me përshtatjen e kurrikulave arsimore me tendencat e turizmit dhe nevojat e sektorit. Në këtë mënyrë, arsimi profesional nuk konsiderohet thjesht një mekanizëm formimi, por një mjet për të siguruar që rritja ekonomike e sektorit të mbështetet nga një fuqi punëtore e aftë për t'iu përgjigjur kërkesave të tij. Në lidhje me këtë strategji (Strategjia Kombëtare e Turizmit 2024 – 2030, 2024, f. 27) parashikon:

- përafrimin e kurrikulave të arsimit profesional dhe universitar me nevojat e industrisë turistike;
- forcimin e sistemit dual dhe zgjerimin e praktikave profesionale në bashkëpunim me biznesin;
- ngritjen e qendrave të kompetencës dhe programeve të certifikimit sipas standardeve ndërkombëtare;
- promovimin e trajnimeve të vazhdueshme dhe formimit gjatë gjithë jetës.

Sipas vlerësimeve të Horwath HTL, kompania ndërkombëtare që ka asistuar në hartimin e Strategjisë Kombëtare të Turizmit, në vitin 2023 në degët e turizmit të shkollave profesionale publike ishin të regjistruar rreth 2,900 nxënës, ndërsa në arsimin e lartë numri i studentëve arrinte në 2,312. Megjithatë ky numër nuk tregon nëse nevojat e tregut plotësohen ose do të ketë qëllim që të rritet në të ardhmen. Duhet përmendur që strategjia parashikon rritje të numrit të nxënësve deri në 60%, ndërsa numri i studentëve të shkojë deri në 3810. Në lidhje me këtë, propozohen një sërë ndërhyrjesh në sistemin arsimor. Së pari, ajo kërkon përmirësimin e arsim-

it formal përmes përditësimit të kurrikulave në universitete, shkolla profesionale dhe institucionet e tjera arsimore. Kjo kërkesë vjen pasi industria e turizmit ndryshon me ritme të shpejta dhe nuk mund të mbështetet në programe mësimore të pandryshuara. Nga ana tjetër ajo e vendos theksin në integrimin e praktikave në procesin mësimor, zhvillimin e programeve të reja me fokus tek praktika dhe mbi të gjitha bashkëpunimi me biznesin në mënyrë që mësimi të ketë bazë punën. Dokumenti argumenton se cilësia e arsimit profesional nuk mund të garantohet vetëm brenda klasës, por kërkon një ndërveprim të vazhdueshëm me tregun e punës. Synimi është që **praktikat profesionale të mos mbeten një element formal i procesit mësimor**, por të shndërrohen në një mekanizëm real për përvetësimin e aftësive dhe integrimin e të rinjve në tregun e punës.

Një tjetër mënyrë që mund të ndihmojë në këtë bashkëpunim lidhet me ngritjen e qendrave rajonale të kompetencës në fushën e hoteleri-turizmit. Këto qendra parashikohen të funksionojnë si hapësira ku arsimi profesional, biznesi dhe institucionet publike bashkëpunojnë për të ofruar trajnime, praktika dhe programe zhvillimi profesional. Modeli i propozuar mbështetet në përvoja të vendeve të tjera europiane dhe synon të krijojë një lidhje më të fortë ndërmjet arsimit dhe tregut të punës.

Përtej arsimit formal (arsimimit në shkolla), strategjia i kushton rëndësi edhe arsimit joformal dhe trajnimeve profesionale. Kjo lidhet me trajnimin dhe kualifikimin e forcës punëtore aktuale me anë të seminareve, trajnimeve apo programeve të certifikimit etj.

Në tërësi, dokumentet strategjike tregojnë një konsensus të qartë institucional mbi faktin se zhvillimi i turizmit dhe zhvillimi i arsimit profesional janë procese të ndërlidhura. Të gjitha dokumentet e analizuara identifikojnë si prioritete të përbashkëta harmonizimin e kurrikulave me nevojat e tregut, zgjerimin e praktikave profesionale, forcimin e bashkëpunimit me biznesin dhe rritjen e numrit të të rinjve që zgjedhin arsimin profesional. Megjithatë, mbetet për t'u parë nëse këto objektiva strategjike janë përkthyer në mekanizma efektivë dhe në rezultate konkrete në praktikë. Pikërisht këtë dimension synon të analizojë pjesa e mëtejshme e raportit përmes intervistave me institucionet arsimore, nxënësit dhe institucionet publike.

KAPITULLI 2/ RAPORT MBI LIDHJEN MES INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT PROFESIONAL, INSTITUCIONEVE SHTETËRORE DHE BIZNESIT, NGA PERSPEKTIVA E DREJTUESVE TË INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT PROFESIONAL

Shkollat profesionale kanë për qëllim të përgatisin të rinjtë për të qenë sa më herët të gatshëm për tregun e punës. Kjo do të thotë se ata janë më të kualifikuar kur vijnë nga shkollat profesionale dhe kjo sjell po ashtu edhe rritje të shërbimit për sektorin. Ndjekja e shkollës profesionale nuk është në nivelet e nevojshme, ndaj edhe vitet e fundit i është dhënë fokus edhe nga qeveria. Kjo vjen edhe prej faktit se tregu ka nevojë për forca të reja pune të pajisura me disa dije dhe aftësi elementare.

Në përpjekjen që shkolla t'i përshaten tregut, ato kanë gjetur alternativa. Deri para pak vitesh shkollat profesionale kryenin disa orë praktike për nxënësit në biznese. Prej dy vitesh po pilotohet sistemi dual i cili konsiston në kryerjen e praktikës në biznes, pra kemi integrim të lëndëve mësimore dhe praktikës në biznes.

Në zhvillimin e turizmit dhe zgjerimin e këtij sektori, këto shkolla fitojnë vëmendje edhe më të madhe, ndaj edhe është e nevojshme të shohim nga afër se çfarë ndodh dhe si e shohin të gjithë faktorët kyç të këtij zhvillimi. Në vazhdim kemi evidentimin e disa prej sukseseve dhe sfidave, parë nga perspektiva e drejtuesve të shkollave profesionale.

2.1 Aspekti institucional

Bashkëpunimi mes institucioneve shtetërore, institucioneve të arsimit profesional dhe bizneseve ka ndërtuar disa metoda të cilat janë pozitive dhe e lehtësojnë këtë proces. Duhet pasur parasysh se institucioni i cili merret drejtpërdrejt me Institucionet e Arsimit Profesional, Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, është krijuar prej 6 vitesh dhe ka ndërtuar praktika pune që bashkëpunimi të jetë sa më funksional dhe i lehtë.

Edhe nga intervistat me drejtues apo përfaqësues të institucioneve të arsimit profesional, bashkëpunimi me AKPA-në vlerësohet pozitivisht. Format e komunikimit janë nga më të ndryshmet e këtu përmenden raportime, statistika, vizita monitorimi, manuale, takime, panaire dhe mundësi për të dhënë sugjerime. Kjo tregon se kanali vertikal ndërmjet agjencisë dhe shkollave perceptohet si funksional dhe në përmirësim.

Vështirësia më e madhe shfaqet në koordinimin me arsimin 9-vjeçar dhe gjimnazet. Sfidat fillojnë në afrimin e nxënësve drejt arsimit profesional; madje zonat të cilat janë të prekura më

shumë prej emigrimit ndjehet njëfarë gare mes arsimit profesional dhe atij të përgjithshëm, pasi secila prej tyre do të ruajë institucionet përkatëse prej efekteve që rënia e numrit të nxënësve sjell. Në këtë situatë, shkollat profesionale kërkojnë më shumë mbështetje nga niveli qendror duke kërkuar që ato të bëjnë një orientim dhe edukim të prindërve dhe fëmijëve përmes fushatave informuese për sensibilizim.

Sistemi është më i organizuar brenda linjës së arsimit profesional sesa ndërmjet sistemeve të ndryshme arsimore. Shkollat profesionale e ndiejnë rekrutimin e nxënësve si barrë individuale, jo si përgjegjësi të përbashkët të institucioneve. Duke shtuar edhe mundësitë që shkollat kanë për të bërë bashkëpunime apo për të kërkuar mbështetje nga shkolla të tjera jashtë vendit, vjen një barrë të shtuar për stafin e shkollës. Tashmë drejtuesit dhe stafet përveç aftësive dhe formimit akademik duhet të kenë edhe aftësi menaxheriale. Edhe pse ka trajnime herë pas here nga institucionet përgjegjëse, duket se nuk ka arritur të shtrihet në të gjithë shkollat profesionale.

Sistemi i raportimit dhe monitorimit është një model i mirë dhe jep mundësinë që gjendja e shkollës të ndiqet e analizohet si nga ana sasiore, ashtu edhe ajo cilësore. Por shpesh stafit dhe drejtuesve ju duhet të raportojnë të njëjtën gjë në dy institucione të ndryshme; kjo perceptohet si disi sfiduese dhe duhet të mendohet një mënyrë ku raportimi bëhet vetëm në një institucion, pa rënë në përsëritje. Pra duhet të ketë qarkullim të informacionit më të mirë mes institucioneve përgjegjëse.

2.2 Popullata e nxënësve

Shkollat nuk kanë të njëjtën prirje për sa i përket interesit të nxënësve. Shkollat që janë në zona më urbane dhe qytete më të mëdha raportojnë interes të shtuar, ndërsa qytetet më të vogla raportojnë rënie. Kjo tregon se numri i regjistrimeve ndikohet nga konteksti lokal dhe nuk mund të shpjegohet me një faktor të vetëm. Duhet nënvizuar se emigrimi dhe rënia e lindjeve ndikojnë drejtpërdrejtë në rënien e numrit të nxënësve.

Nga intervistat rezulton se disa faktorë që ndikojnë në zgjedhjen e shkollës janë: siguria e punësimit, pasioni, ndikimi i prindërve dhe shoqërisë, perceptimi për statusin e gjimnazit, bursat, transporti, kushtet ekonomike, emigrimi dhe numri i përgjithshëm i nxënësve në zonë.

Po ashtu rol të rëndësishëm luan edhe orientimi aktual që duket i lidhur fort me promovimin e shkollës. Drejtuesit zhvillojnë vizita, fushata në rrjete sociale dhe ditë të hapura në shkollë, por kërkojnë që edukimi i karrierës të fillojë më herët dhe të mos varet vetëm nga përpjekjet e shkollës profesionale. Përgjigjet sugjerojnë nevojën për një proces ku nxënësi dhe prindi njihen me të gjitha profilet, jo vetëm me kuzhinën ose me idenë e përgjithshme të “një zanati”.

Aktualisht nxënësit janë vetë-orientuar drejt profilit të kuzhinës prej pasionit dhe mundësive që kjo ofron në treg, që lidhet për më tepër edhe me ambiciet dhe mundësitë për të hapur një biznes.

2.3 Marrëdhënia e biznesit dhe tregut të punës

Për shkollat është me rëndësi bashkëpunimi me bizneset sepse praktika e drejtpërdrejtë i aftëson më shumë nxënësit. Shkollat duket se kanë rrjete të gjera me biznese. Bashkëpunimi nuk kufizohet te dërgimi i nxënësit në praktikë, por përfshin përzgjedhjen e nxënësve, kontratat, mentorimin, vlerësimin, pjesëmarrjen në provime dhe feedback-un për kurrikulën dhe në disa raste biznesi është pjesë e bordit të shkollës apo stafit akademik.

Megjithatë, jo çdo marrëveshje është aktive pasi jo të gjitha bizneset pranojnë nxënës për praktikë. Kjo tregon se duhet bërë dallimi ndërmjet një memorandumit formal dhe një partneriteti që realizon praktikë, mentorim dhe vlerësim. Gjendur në këto kushte biznesi pranon ose jo në bazë të nevojës që ai ka për staf dhe nuk ka asnjë mekanizëm që të detyrojë atë të pranojë nxënës për praktikë.

Sfidë mbetet gjetja e bizneseve me të cilët lidhet memorandumit, sepse bizneset duhet të plotësojnë disa kriterë sa i përket numrit të të punësuarve. Bashkëpunimi duket gjithashtu shumë i varur nga angazhimi personal i drejtuesve, koordinatorëve dhe mësuesve sepse janë ata që gjejnë këto biznese në shumicën e rasteve. Kjo ka anët e saj pozitive dhe negative, sepse nga një anë është forcë, sepse krijon besim dhe reagim të shpejtë, por edhe dobësi, sepse rezultatet mund të varen tepër nga individët dhe rrjetet e tyre personale.

Procesi i praktikës ka shumë sfida, që nga gjetja e biznesit të përshtatshëm, firmosja e marrëveshjes, ndjekja e praktikës, etj. dhe kjo punë nuk shoqërohet me një mbështetje të mjaftueshme financiare. Një ndikim të rëndësishëm në bashkëpunim luan angazhimi i mësuesve që duhet të ndjekin praktikën e nxënësve, të ciltë shprehen se nuk paguhën për punën dhe orët jashtë-mësimore që zhvillojnë. Kjo sigurisht mund të sjellë ndikim dhe në performancën e mësuesve në punën e tyre dhe në marrëdhënien mes tyre dhe bizneseve dhe nxënësve, pavarësisht se përpjekjet e tyre janë maksimale.

2.4 Kurrikula dhe përputhja me kërkesat e tregut

Përgjigjet janë të ndryshme dhe shkollat kanë eksperiencë të ndryshme duke treguar se ka nivele të ndryshme të fuqisë për të ndikuar në kurrikula. Disa prej tyre vlerësojnë se zëri i biznesit dëgjohet ndjeshëm dhe se mësuesit e biznesit marrin pjesë në grupet e punës. Për disa të tjerë kurrikula perceptohet si më statike dhe me hapësirë të kufizuar për ndërhyrje ose se sugjerimet merren, por përditësimi nuk mund të bëhet shpejt për të gjitha kurrikulat.

Ky dallim tregon se mekanizmi i feedback-ut ekziston, por përvoja e shkollave me të nuk është e njëtrajtshme. Shkolla mund të japë sugjerime, por jo gjithmonë ato reflektohen në kohën e duhur. Fushat e sugjeruara për përditësim janë disa, por më konkrete janë: housekeeping dhe shërbim-pastrimi, shërbimi në hoteleri dhe bar-restorant, barista, recepsioni, gjuhët e huaja. Së fundmi, edhe aftësitë e buta mbeten sfida e që në këndvështrimin e drejtuesve të shkollave përbëjnë një problem që nuk zgjidhet vetëm me anë të mësimit teorik.

KAPITULLI 3/ PERSPEKTIVA E NXËNËSVE MBI LIDHJEN MES INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT PROFESIONAL, INSTITUCIONEVE SHETËRË DHE BIZNESIT

Analizat e “Skills for Jobs” mbartin një mesazh të qartë mbi arsimin profesional dhe sistemin dual. Sipas këtyre analizave arsimit profesional në shqipëri nuk është më një zgjedhje “e dorës së dytë”. Ai po shndërrohet në një rrugë të shpejtë drejt një pune të denjë, me paga në rritje dhe me një rrezik shumë më të ulët për papunësi në krahasim me disa degë të arsimit të përgjithshëm apo universitar. Për të parë se si këto elementë i përkojnë realitetit të nxënësve-punëtorë, në këtë pjesë të raportit paraqesim në mënyrë të përmbledhur këndvështrimin, eksperiencat dhe vlerësimet e disa nxënësve që studiojnë në degën Hoteleri-Turizëm (kryesisht me profil Kuzhinë) në Shkollën e Mesme Profesionale Hoteleri - Turizem të Tiranës dhe në Shkollën e Mesme Profesionale Kamëz. Në të dyja këto shkolla aplikohet sistemi dual. Raporti i mëposhtëm bazohet në analizën e disa pyetësorëve përmes të cilëve nxënësit-punëtorë kanë dhënë vlerësimin e tyre mbi ndërlidhjen mes formimit që merret në shkollë dhe përvojës praktike që ata zhvillojnë pranë bizneseve të ndryshme, duke e vënë theksin te sistemi i arsimit dual, raporti me mësuesit, kushtet e mësimit dhe kushtet e punës në vendin ku zhvillohet praktika.

3.1 Vlerësimi i shkollës, formimit teorik dhe praktik (laboratorët)

Nxënësit në përgjithësi shprehin një vlerësim pozitiv për stafin pedagogjik dhe mbështetjen institucionale që marrin nga shkollat e tyre. Mësuesit përshkruhen si të gatshëm për të shpjeguar, mbështetës dhe ndihmues në çdo hap, gjë që u jep nxënësve më shumë siguri.

Për sa i përket infrastrukturës mësimore, më specifikisht laboratorëve ku ata bëjnë praktikën, këtu hasim në disa ndryshime mes shkollave. Nxënësit e shkollës profesionale të Kamzës vënë në dukje se shkolla e tyre nuk ofron kushte të mirëfillta për praktikë brenda institucionit. Njëri prej tyre shprehet hapur: “*S’ka laboratorë...*” - duke shtuar se e gjithë pjesa e praktikës bëhet nëpër biznese. Pra kemi një varësi të plotë nga biznesi në lidhje me praktikën dhe shkolla ofron vetëm anën teorike të të nxënësit. Ndërsa nxënësit e shkollës së Tiranës shprehin se shkolla e tyre ka laboratorë të mirëpajisur, madje sikundër shprehet një nga nxënësit, me mjete të teknologjisë së fundit që ndonjëherë tejkalojnë edhe ato të bizneseve.

Një shqetësim jo i vogël është mungesa e herëpashershme e lëndëve të para (si mishi apo peshku) në kuzhinat e shkollës për shkak të kostove të larta, gjë që kufizon mundësinë për të ushtruar gatime specifike përpara se të dalin në tregun e punës.

Rreth përgatitjes së shkollës për tregun e punës ka nga ata që shprehen se shkolla i ka përgatitur mirë, por ka gjithashtu nxënës që mendojnë se kjo përgatitje nuk është e mjaftueshme, duke e vënë theksin te nevoja për shtimin e ditëve të praktikës çka do sillte më pas rritje të eksperiencës, rritje të disiplinës, hapje të kuzhinës aty ku mungon, dhe përmirësim të pajisjeve.

3.2 Praktika profesionale në biznese

Sistemi dual, i cili aplikohet sipas skemës “dy ditë mësim në shkollë dhe tri ditë praktikë në biznes”, vlerësohet përgjithësisht si një praktikë e mirë nga shumica e nxënësve të intervistuar. Sipas tyre kjo formë organizimi e shkollës profesionale u jep një siguri të madhe dhe i ndihmon të bëjnë një lidhje më të mirë me tregun e punës.

Bashkëpunimi mes shkollës dhe biznesit gjatë praktikës në përgjithësi ka qenë i mirë, sipas nxënësve.

Gjatë praktikës në biznese (si hotele apo restorante), nxënësit tregojnë se kryesisht kanë fituar si aftësi teknike, ashtu edhe aftësi të buta (soft skills) si sjellja në punë, puna në grup, menaxhimi i fluksit të punës, shpejtësia dhe durimi.

Marrëdhënia me mentorët në biznese vlerësohet përgjithësisht si e mirë. Nga bisedat me nxënësit, vërehet se mentorët dhe shefat e kuzhinës i drejtojnë nxënësit sipas planeve të praktikës, duke i këshilluar dhe mbështetur edhe në rastet kur bëjnë gabime me recetat.

Sa i përket monitorimit nga shkolla të nxënësit, këtë të fundit e vlerësojnë pozitivisht praninë e herëpashershme të mësuesve të praktikës në biznese, por disa sugjerojnë se një monitorim më i shpeshtë (disa propozojnë një herë në javë) do t'u jepte më shumë siguri gjatë praktikës.

3.3 Sfidat, shfrytëzimi dhe kushtet e punës

Pavarësisht suksesit të sistemit dual dhe raportit të shkollës me bizneset, gjatë intervistave kanë dalë në pah edhe disa problematika dhe nuanca të ndryshme sa i përket marrëdhënies së nxënësve me mësimin, bizneset dhe sa i përket kushteve të punës.

Për shkak të angazhimit në praktikë apo punës që njëkohësisht janë të detyruar të bëjnë disa prej nxënësve, nga intervistat rezulton se sistemi dual ka ndikuar disi negativisht në rezultatet e shkollës, pasi i kanë lënë pas dore lëndët e përgjithshme dhe shkencore për t'i kushtuar më shumë kohë praktikës në kuzhinë.

Në lidhje me praktikën, hasim raste të mospagesës së praktikës. Ndërsa ka nxënës që arrijnë të punësohen formalisht sipas ligjit dhe të paguhen gjatë praktikës, ka ende raste (siç dëshmon një prej nxënësve të Kamzës) ku kontrata mes palëve parashikonte pagesë, por mentori apo biznesi nuk e ka kryer atë, gjë që ka çuar në lënien e praktikës dhe në demotivim të thellë të nxënësit, duke nënënien në pikëpyetje të ardhmen e tij si kuzhinier.

Problemet fillojnë me daljen në tregun e punës. Për sa i përket kushteve të punës në turizëm gjatë sezonit turistik, një prej nxënësve shprehet se:

“Gjatë sezonit... domethënë gjatë sezonit turistik, zonat kryesisht bregdetare i shfrytëzojnë pak punëtorët,edhe nxënësit që janë në një moshë, le të themi, 18 vjeç, i shfrytëzojnë më shumë se ç’duhet. Edhe i shkelin... i shkelin edhe rregullat e punës, pagat.”

Një problem i rëndësishëm është ai i orëve të zgjatura të punës. Studentët pohojnë se puna në sektorin e turizmit kërkon sakrifica të mëdha. Gjatë sezonit veror në zonat bregdetare, ata vënë re një tendencë të bizneseve për të shfrytëzuar sidomos të rinjtë. Orët e punës gjatë sezonit mund të shkojnë nga 12 deri në 16 orë në ditë, dhe ditët e pushimit janë pothuajse të pamundura për t’u marrë. Një prej nxënësve pohon se ka punuar, mes orëve të praktikës dhe punës, deri në 56 orë në javë, gjë që është në shkelje të Kodit të punës. Disa restorante, sipas nxënësve, nuk i paguajnë orët shtesë të punës që vijnë prej porosive të fundit apo për të pastruar kuzhinën.

Për sa i përket çështjes së pagës në turizëm, nga intervistat del se pagat në turizëm janë të kënaqshme ose në rritje. Mirëpo megjithëse pagat janë të kënaqshme, nxënësit që punojnë aty pohojnë se nga ana tjetër kemi orë të zgjatura të punës. Duke qenë se paga mujore në shumicën dërmuese të rasteve është fikse dhe e paracaktuar gojariisht, orët shtesë në këto raste nuk paguhen. Ka edhe nxënës që pohojnë se pagat janë jo shumë të mira krahasuar me kushtet e punës.

Sa i përket pushimeve, kështu përgjigjet një nxënës i intervistuar: *“Për sa i përket pushimeve, mund t’i marrësh... në qoftë se i ke punët mirë, mund ta marrësh një ditë në muaj për shembull, në sezon. Se është vështirë të marrësh ditë pushimi. Do të bësh sakrifica...”*. Shfrytëzimi dhe intensiteti në punë janë shumë të lartë gjatë kësaj periudhe, për shkak të mungesës së respektimit të ligjeve të punës dhe të mungesës së kontroleve nga ana e institucioneve përgjegjëse.

Në lidhje me informalitetin, përgjithësisht nxënësit gjatë praktikës kanë kontrata pune të rregullta, megjithëse sikundër e pamë ka raste kur ato nuk respektohen. Ndërsa kur dalin më pas në tregun e punës, këta nxënës-punëtorë nuk punojnë me kontrata pune të rregullta, madje ka raste kur nuk kanë një kontratë pune. Gjendja përkeqësohet gjatë punës sezonale ku informaliteti është shumë i lartë.

Në mbyllje, duhet përmendur problemi i fragmentimit të punës gjatë vitit. Për pjesën dërmuese, puna në turizëm është e ndarë në dy kohë. Njëra është puna në hotele apo restorante të qytetit (8 muaj e gjysmë afërsisht), ndërsa pjesa tjetër është puna sezonale në zonat bregdetare (3 muaj e gjysmë). Dallimi mes tyre gjendet tek kushtet e punës dhe siguria e punës, si kontrata e punës, paga, orët e punës, pushimi, etj. Për shembull, puna në sezonin e verës në bregdet paguhet sa dyfishi i punës gjatë pjesës tjetër të vitit. Ndërsa puna në qytet është me kontratë pune dhe më e qëndrueshme për sa i përket kushteve, ajo sezonale është informale, me orare të zgjatura (nga 12 deri në 16 orë në ditë) dhe e paqëndrueshme. Ja si shprehet një nxënës i intervistuar:

“Sezoni e ka këtë, ka orarin, e ka më të gjatë. Do punosh 8 në Tiranë, do punosh 10 orë atje, 12 orë...” Nxënësi-punëtor në këtë rast është gjithnjë i lëkundur mes dy situatave, mes dy punësh të kundërta: *“...gjatë sezonit, domethënë gjatë sezonit turisti, zonat kryesisht bregdetare i shfrytëzojnë pak punëtorët, edhe me raset edhe nxënësit që janë në një moshë, le të themi, 18 vjeç, i shfrytëzojnë më shumë se ç’duhet. Edhe i shkelin rregullat e punës, pagat. Kurse gjatë vitit, nuk besoj se ka shkelje të tilla, nuk kam konstatuar ndonjë gjë.”*

3.4 E ardhmja profesionale

Sa i përket të ardhmes profesionale pikëpamjet mund t'i ndajmë në dy grupe sipas nivelit të motivimit që ata shfaqin.

Grupi i të motivuarve janë ata që e shohin të ardhmen me pozitivitet pavarësisht disa problemeve që ata hasin, të cilët përbëjnë shumicën e të intervistuarve. Nxënësit që e kanë pasion kuzhinën shprehen shumë të vendosur për të vazhduar në këtë sektor. Synimi i tyre kryesor për të ardhmen është të bëhen shefa kuzhine ose të hapin bizneset e tyre (restorante apo pastiçeri) brenda Shqipërisë. Dëshira e disa prej tyre është që fillimisht të marrin eksperiencë jashtë vendit (si në Francë), e më pas të rikthehen apo të investojnë këtu, pasi e shohin turizmin si një sektor në rritje të madhe. Të motivuarit janë edhe më të prirur të ndjekin arsimin e lartë në të njëjtën degë apo një fushë të ngjashme.

Grupi i dytë janë të demotivuarit. Këtu bëjnë pjesë nxënës që e kanë ndjekur hotelieri-turizmin pa një plan të mirëmenduar ose që kanë patur eksperiencë negative gjatë praktikës (për shembull, mospagesë e praktikës) dhe deklarojnë se nuk e gjejnë veten në kuzhinë. Këta nxënës planifikojnë të angazhohen në një profesion tjetër pas mbarimit të shkollës profesionale.

Për sa i përket çështjes së emigrimit, nga intervistat del se është i lidhur me një varg faktorësh, siç janë dështimi i institucioneve arsimore për të motivuar nxënësin, për t'i dhënë siguri, mosbesimi në institucionet shtetërore, papjekuria dhe ashpërsia e tregut të punës, dëshira për një jetë më të mirë etj. Pjesa më e madhe e nxënësve të intervistuar duket e vendosur për të qëndruar në Shqipëri dhe për të vazhduar punën në profesionin e zgjedhur për shkak të pasionit dhe të ardhurave që garanton, duke i lënë në plan të dytë problemet. Ndërkohë ka të tjerë që, kryesisht për shkak të abuzimeve të bizneseve të sektorit të turizmit, mungesës së kushteve të denja të punës apo mosbesimit në institucionet shtetërore, zgjedhin opsionin e largimit. Prej këtyre, disa e shohin emigrimin si të vetmen zgjidhje, disa e shohin si opsion të dytë ose të kushtëzuar nëse del ndonjë rast i mirë, disa të tjerë e shohin si largim i përkohshëm, sezonal.

KAPITULLI 4/ ROLI I AKPA-SË NË MENAXHIMIN E ARSIMIT PROFESIONAL DHE INTEGRIMIN E TË RINJVE NË TREGUN E PUNËS

Kjo pjesë e raporti përqendrohet në rolin e AKPA-së si nyje lidhëse mes Arsimit dhe Formimit Profesional (AFP) dhe tregut të punës dhe është përgatitur bazuar në një intervistë të thelluar me një drejtues të lartë të AKPA-së.

Qysh prej vitit 2020, AKPA ka marrë në menaxhim të dejtpërdrejtë shkollat profesionale, një kompetencë që më parë mbahej nga Ministria e Arsimit. Qëllimi i këtij ndryshimi institucional ishte që t'i jepej rëndësia e merituar arsimit profesional, në mënyrë që të mos konsiderohej më si një «zgjedhje e dorës së fundit», por të bashkërendohej organikisht me politikat e punësimit. Pikat kyçe të këtij integrimi janë, sipas AKPA-së, garancia rinore dhe studimi i tregut. Garancia rinore sjellë si një mundësi konkrete për bashkëpunim të ndërsjellë mes arsimit dhe tregu.

Për AKPA-në "asimi profesional po shihet si një model mire dhe përqindja e nxënësve që ndjekin këto shkolla është në nivel më të lartë. Sistemi dual që po provohet këto dy vite është më afër tregut të punës. Duket se përmes tij, mund t'i plotësojmë nevojat e biznesit. Sipas të dhënave që kemi, niveli i punësimit është 64% në total të nxënësve që dalin nga shkollat profesionale, në turizëm është 80% niveli i punësimit."

Raporti i AKPA-së me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit në fillim ka qenë i vështirë për shkak të kalimit të funksioneve, por tani është përmirësuar. Megjithatë ka disa aspekte që duhen qartësuar në lidhje me nevojat që ka AKPA dhe plotësimi i tyre nga ministria; bashkëpunimi me Agjencinë Kombëtare të Arsimit dhe Formimit Profesional dhe Kualifikimeve për riorientimin e ofertës. Qartësi duhet bërë në lidhje me menaxhimin e projekteve, ku ka një problem në hierarki, si për shembull miratimi i tyre.

Tranzicioni administrativ nga ministria përgjegjëse drejt agjencisë ka qenë i vështirë. Ka patur sfida për sa i përket funksionimit institucional dhe gjetjes së kapaciteteve administrative në shkolla për pozicione si financier apo jurist. Shndërrimi i drejtuesve të shkollave në menaxherë ka qenë një zgjidhje që ka AKPA është munduar të japë, duke iu dhënë drejtuesve njohuritë e duhura ligjore dhe procedurale financiare.

Marrëdhënia mes AKPA dhe shkollave sot është vertikale, pra kemi një monitorim administrativ, statistikash dhe standardizimi të manualeve të punës që vjen nga lart. Shkollat gjithsesi mbeten ente më vete sa i përket vendimmarrjes për menaxhimin e fondeve.

Përmbajtja dhe organizimi i kurrikulave, si një element thelbësor i përshtatjes mes arsimit dhe tregut të punës, sipas AKPA-së bazohet në studimet që ata bëjnë në bashkëpunim me biznesin. Bizneset janë mjaft të përfshira në sistem, pasi ato kanë të drejtë të japin referenca dhe të ndryshojnë deri në 20% të kurrikulës në bashkëpunim me shkollat për praktikat mësimore. Edhe trajnimet e mësuesve nga vetë institucioni apo dhe donatorë të huaj janë një praktikë e zakonshme që synon përmirësimin e kurrikulës dhe procesit të mësimdhënies. Në përafrimin e shkollës me tregun, një sfidë për AKPA-në ka të bëjë me standardet e ndryshme të certifikimit

ku *de jure*, nxënësit në të gjithë territorin e Shqipërisë dalin me të njëjtën certifikatë, por *de facto* ajo “nuk ka të njëjtën vlerë dhe cilësi” praktike kudo. Kjo vjen si për shkak të stafit pedagogjik që është i vështirë për tu gjetur në Sarandë për shembull, por edhe për shkak të biznesit.

Në lidhje me dinamikat e popullatës së nxënësve dhe tregut të punës, sipas AKPA ka rritje të interesit për arsimin profesional, sidomos për profilet hoteleri-turizëm. Mirëpo numri i nxënësve është i pamjaftueshëm, për shkak se ata kërkojnë të punojnë afatëgjatë, kërkojnë një punë të qëndrueshme, ndërsa puna sezonale është e përkohshme. As ngarkesa sezonale nuk do të plotësohet kurrë vetëm nga nxënësit. Sipas drejtuesve, shtimi dhe përmirësimi i konvikteve shihet si një mjet kryesor për të afruar nxënësit nga zonat rurale drejt shkollave profesionale.

Sistemi dual (i provuar intensivisht në dy vitet e fundit) vlerësohet si një model shumë i mirë që i përgatit dhe i afron nxënësit me tregun e punës dhe plotëson nevojat e bizneseve. Sipas të dhënave të AKPA-së shkalla e përgjithshme e punësimit të të diplomuarve në degën e turizmit është 80%.

Bashkëpunimin me biznesin është pozitiv, por për ta bërë edhe më efektiv, AKPA thekson nevojën për koordinim më të mirë në nivel lokal përmes zyrave të punës, të cilat duhet t’u ofrojnë shkollave lista biznesesh në momentet kur ato kanë mungesa partneritësh.

Hendeku më i madh sot mes biznesit dhe shkollës sipas AKPA-së qëndron te zhvillimi teknologjik. Biznesi është në avantgardë dhe shumë më përpara se shkollat sa i përket teknologjisë.

Për sa i përket stafit pedagogjik, ka mungesë të përditësimit të aftësive të mësuesve dhe vështirësi në zëvendësimin e stafit, sidomos në periferi si në Gjirokastrë apo Sarandë. Në lidhje me punën jashtë mësimore të mësuesve, ata duhet të paguhen edhe për orët e punës dhe transportin kur shkojnë për monitorim të biznesi, ashtu sikur të ishin në shkollë.

Në lidhje me reflektimet për të ardhmen, ajo çfarë funksionon mirë dhe duhet ruajtur sipas AKPA-së është: a) linja vertikale e komunikimit e krijuar nga AKPA; b) standardizimi i sistemit; c) koordinimi lokal; d) programi i Garancisë Rinore; e) dhe krijimi i një edukate të mirë pune të nxënësit.

Një prej detyrave kryesore të AKPA-së do të jetë rritja e performancës së shkollave profesionale. Përmes tyre do të ndikohet te strukturat akomoduese të mirëfillta, përjashto ato sezonale. Duhet bërë politika që tërheqin nxënës më të mirë, pasi shkollat profesionale janë zgjedhje e dytë. Megjithatë ka një përmirësim krahasuar me të kaluarën. Përmirësim duhet të ketë edhe në rrafshin e disiplinës e cila duhet rritur përmes afrimit të ekspertëve të fushës. Për të patur një rritje duhet aplikuar edhe stimulantë të ndryshëm siç janë bursat, konviktet apo aktivitete argëtuese në fundjavë.

KAPITULLI 5/ NGA SHKOLLA TE BIZNESI, PARË NË KËNDVËSHTRIMIN E BIZNESIT

Për të kuptuar lidhjen mes shkollës dhe tregut nga perspektiva e biznesit, në mungesë të intervistave me përfaqësues të kësaj kategorie, po paraqesim një analizë të vlerësimit të biznesit parë nga studiues të fushës, nga strategjia kombëtare e punësimit, dhe disa të dhëna të nxjerra nga intervistat me drejtuesit e shkollave dhe nxënësit.

Në një analizë të bërë mbi lidhjen mes klasës dhe karrierës, Myqerem Tafaj, (Tafaj, 2025) shpreh se në çdo studim apo anketim që bëhet edhe në vendin tonë, sipërmarrja e vlerëson të pakënaqshëm nivelin e përgatitjes së të porsadiplomuarve, sidomos atë të formimit praktik të tyre. Aspekti cilësor është një element kyç i formimit të punëtorëve dhe i funksionimit të tregut të punës, të cilin sipërmarrjet përpiqen ta rregullojnë përmes stazheve disamujore apo kurseve të ndryshme. Për sa i përket nxënësve të dalë nga hotelieri-turizmi, parë nga kënvështrimi i drejtuesve të shkollave, ata kanë përgatitjen e mjaftueshme për tregun e punës, dhe aty ku hasen probleme kemi përpjekje për përmirësimin e kurrikulës mësimore që bëhet në bashkëpunim me sipërmarrjet. Kjo ka ndihmuar në uljen e hendekut cilësor mes shkollës dhe sipërmarrësve.

Edhe në Strategjinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive 2023–2030 përmenden sfidat me të cilat **përballen bizneset në Shqipëri** (Ministria e Financave, 2022). Në këtë strategji identifikohen disa nga shqetësimet e raportuara nga bizneset që lidhen me mungesën e punonjësve të kualifikuar dhe raporti i pabalancuar midis pagës dhe produktivitetit në punë.

Një problematikë mjaft e rëndësishme ka të bëjë me mungesën e krahut të punës. Problemi sasior i të diplomuarve në shkollat e hotelieri-turizmit theksohet shumë gjatë intervistave me përfaqësuesit e shkollave por edhe me vetë nxënësit, të cilët shprehen se numri i nxënësve që dalin nga shkollat profesionale është i pamjaftueshëm për të mbuluar nevojat që kanë bizneset për krah pune. Kërkesa e lartë që u vjen shkollave të hotelierisë nga bizneset, është shumë e vështirë ta përmbushet për shkak të një sërë arsyesh si emigrimi i familjeve, mungesa e interesit për shkollat profesionale nga të rinjtë dhe probleme të tjera social-kulturore.

PËRFUNDIME

Të dhënat tregojnë se sektori i turizmit po rritet me hapa shumë të shpejtë, duke shënuar rekorde të hyrjes së vizitorëve (mbi 12 milionë në 2025), duke kontribuar me 25% në PBB, dhe duke krijuar një kërkesë të lartë për punonjës. Megjithatë, numri i nxënësve të regjistruar në arsimin profesional mbetet i ulët dhe i pamjaftueshëm për të mbuluar nevojat e tregut, i ndikuar kryesisht nga emigracioni, rënia demografike dhe perceptimi i arsimit profesional si një “zgjedhje e dorës së dytë”.

Sistemi dual (dy ditë mësim teorik në shkollë dhe tri ditë praktikë në biznes) i aplikuar vitet e fundit në shkollat profesionale vlerësohet mjaft pozitivisht nga AKPA-ja, drejtuesit e shkollave dhe vetë nxënësit. Ky model ka rritur ndjeshëm shkallën e punësimit, e cila në degën e turizmit arrin deri në 80%, duke dëshmuar se lidhja e drejtpërdrejtë me biznesin lehtëson tranzicionin drejt tregut të punës. Mirëpo bashkëpunimi mes institucioneve dhe biznesit gjatë praktikës duhet përmirësuar në mënyrë që të kemi rezultate më të mira në përgatitjen e nxënësve për tregun e punës dhe në parandalimin e shkeljeve të kontratave të praktikës dhe Kodit të Punës, siç është mospagesa e praktikës.

Ekziston një pabarazi e theksuar në infrastrukturën e shkollave. Ndërsa disa shkolla profesionale, si ajo e Tiranës, kanë laboratorë të pajisur mirë, të tjera shkolla, si ajo e Kamzës, vuajnë nga mungesa e plotë e laboratorëve ose lëndëve të para, duke krijuar varësi totale nga biznesi. Gjithashtu, AKPA pranon se biznesi është shumë më përpara se shkollat sa i përket zhvillimit teknologjik.

Pavarësisht pagave relativisht të larta nxënësit përballen me sfida të rënda gjatë punës sezonale në zonat bregdetare. Gjatë punës raportohen shkelje të Kodit të Punës, si orare të zgjatura (12 deri në 16 orë në ditë, apo deri në 56 orë në javë), mungesë e ditëve të pushimit, si dhe shkallë e lartë e informalitetit në krahasim me punësimin e qëndrueshëm në qytet gjatë vitit. Këto fenomene nxisin demotivimin dhe dëshirën e të rinjve për të emigruar, për të lënë mësimet ose për të ndryshuar profesion.

Marrëdhënia dhe komunikimi vertikal mes shkollave dhe AKPA-s është funksional, por ka raste kur kërkesat e shkollave edhe stafit pedagogjik nuk dëgjohen nga institucionet që qëndrojnë mbi ta. Mësuesit e praktikës përballen me mbingarkesë të papaguar për orët jashtë mësimore dhe transportin gjatë monitorimit të nxënësve në biznese. Me sfida mbetet marrëdhënia mes AKPA-së dhe ministrisë ku hasen shpesh paqartësi në hierarki, si në rastin e menaxhimit të projekteve.

REKOMANDIME

Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit dhe ISHPSHSH duhet të forcojnë inspektimet dhe monitorimin e kushteve të punës në biznese. Inspektorati i Punës duhet të ushtrojë kontrole rigoroze, veçanërisht gjatë sezonit veror në zonat bregdetare, për të ndaluar shfrytëzimin e të miturve/nxënësve, për të garantuar respektimin e orareve sipas ligjit dhe për të sanksionuar informalitetin.

Ministria e Arsimit dhe Sportit, AKPA, etj., duhet të kompensojë financiarisht punën e mësuesve që monitorojnë nxënësit gjatë praktikës në biznese, duke mbuluar orët jashtëmësimore dhe shpenzimet e transportit, për të rritur cilësinë e monitorimit. Sipas sugjerimeve të nxënësve, monitorimi i mësuesit duhet të bëhet deri në një herë në javë dhe të ketë një bashkëbisedim të vazhdueshëm me nxënësin praktikant.

Orientimi drejt arsimit profesional duhet të nisë që në arsimin 9-vjeçar përmes fushatave institucionale që targetojnë prindërit dhe fëmijët, duke hequr barrën e rekrutimit individual nga shkollat dhe duke thyer stigmën e “zgjedhjes së dorës së dytë”.

Një sugjerim që vjen nga AKPA është që të shtohen investimet në konvikte moderne dhe në bursa specifike për të tërhequr nxënësit nga zonat rurale apo periferike drejt qendrave ku ofrohet arsim profesional cilësor në hoteleri-turizëm.

Një rekomandim drejtuar shkollave është garantimi i fondeve të mjaftueshme për ngritjen e laboratorëve bazë në shkollat ku ata mungojnë (si në shkollën profesionale në Kamëz) dhe sigurimi i qëndrueshëm, aty ku mungojnë, i lëndëve të para (mish, peshk etj.) për ushtrimin e praktikës para daljes në treg.

Rekomandohet të shfrytëzohet hapësira prej 20% për ndryshimin e kurrikulës në bashkëpunim me biznesin, duke vënë theksin te profilet si housekeeping, shërbim në hoteleri, barista, reception, gjuhët e huaja dhe zhvillimi i «aftësive të buta». Të organizohen trajnime të vazhdueshme për mësuesit për të zbutur hendekun e zhvillimit teknologjik me industrinë.

Në përfundim, sfidat e arsimit profesional në Shqipëri nuk lidhen vetëm me zgjerimin e ofertës arsimore, por edhe me përmirësimin e cilësisë së saj dhe forcimin e lidhjes me ekonominë. Vetëm një sistem që përshtatet vazhdimisht me ndryshimet teknologjike, bashkëpunon ngushtë me biznesin dhe garanton zhvillimin e kompetencave profesionale e ndërpersonale mund të sigurojë një tranzicion të suksesshëm nga shkolla në një punë të qëndrueshme dhe të denjë. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për sektorin e hoteleri-turizmit, ku zhvillimi i kapitalit njerëzor përbën një nga kushtet themelore për konkurrueshmërinë dhe qëndrueshmërinë e industrisë turistike shqiptare.

BIBLIOGRAFIA

“Skills for Jobs” (S4J). (a.d.). <https://skillsforjobs.al>.

ALTAX. (2024). *Analiza shumëdimensionale e turizmit ne Shqipëri 2024*. Gjetur në <https://altax.al/permbledhje-e-analizes-se-turizmit-ne-shqiperi/>

Altax. (2025). *Asimetria fiskale e turiymit shqiptar*. Gjetur në https://altax.al/product/asimetria-fiskale-e-turizmit-shqiptar/?fbclid=IwY2xjawTDAW1leHRuA2FlbQlXMQBicmlkETFa-VzdoR0NqTk1yMXZBTE1lc3J0YwZhchBfaWQQMjlyMDM5MTc4ODIwMDg5MgABHoJgaRledaaR-CrGttWdKrfS2cd9cEKnfCFTQt-Mtw1Z6dRoAhK-kRVekd69p_aem_nXT770wSP6rVMM0gjOOs9

Billet, S. (2011). *Vocational Education: Purposes, Traditions and Prospects*.

Ministria e Financave. (2022). *Strategjinë Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive 2023–2030*.

Ministria e turizmit dhe mjedisit. (2024). *Strategjia Kombëtare e Turizmit 2024 – 2030*. Gjetur në https://www.konsultimipublik.gov.al/documents/RENJK_785_Strategjia-Kombe%C-C%88tare-e-Turizmit-2024-2030_Update_6_Tetor.pdf

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit. (2025). *Strategjia Kombëtare për Zhvillimin e Turizmit 2025–2030*. Gjetur në https://turizmi.gov.al/wp-content/uploads/2025/08/Strategjia-e-Zhvillimit-te-Turizmit-2025-2030_compressed.pdf

Monitor. (2025). *Qarku i Durrësit dhe Vlorës, epiqendra e punësimit sezonal, për gusht 2024 u shtuan 7,200 vende*. Gjetur në <https://monitor.al/qarku-i-durresit-dhe-vlores-epiqendra-e-punesimit-sezonal-per-gusht-2024-u-shtuan-7200-vende/>

OECD. (2025). *Education at a Glance 2025: OECD Indicators*.

Tafaj, M. (2025, Dhjetor). Nga klasa te karriera, aleanca që lidh shkollën me tregun e punës. *Monitor*, fv. 55-58.

